



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
DREJTORIA EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE

Nr 6135 prot

Ballsh, më 14 / 12 2023

PROJEKT VENDIM

Nr 44 Date 14.12 2023

PER MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TE PUNONJËSVE
DHE BUXHETIT TË VITIT 2024.

Mbeshtetur ne nenet 34,40,41, 55 te ligjit Nr 139/2015 "Per Vetëqeverisjen vendore", ligjin Nr 9936 date 26-08-2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, kreu III nenet 10-20, kreu IV nenet 20-29, kreu VII nenet 39-40 te ligjit Nr 68/2017 "Per Financat e Vetqeverisjes Vendore", Ligjin Nr /2023 "Per Buxhetin e Vitit 2024" ligjin Nr 10296 date 08-07-2010 "Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin Udhezimin nr 6 date 28-02-2023 te Ministrise Financave "Per Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026", i propozojmë këshillit te Bashkise Mallakaster:

1. Të miratojë Buxhetin e vitit 2024 të Bashkisë Mallakastër, si më poshtë:

1.1 Miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Mallakastër dhe të institucioneve në varësi për vitin 2024 sipas tabelës Nr 5 pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi..

1.2 Te miratojë planin e te ardhurave te vitit 2024, gjithsej ne vleren **1.074.041.900** (Njëmiliard e e shtatëdhjetë e katërmilion e dyzetë e një mijë e nëntëqind) leke, sipas kësaj strukture të ardhurash:.

Në lekë

- Të ardhurat nga Taksat dhe tarifat vendore	411.045.000
- Trasferta e Pakushtëzuar	224.006.726
- Trasferta Sektoriale	149.071.984
- Trasferta e Kushtëzuar	269.918.190
- Te ardhura të trashëguara	20.000.000
TOTALI I TE ARDHURAVE	1.074.041.900

1.3. Te miratoj detajimin e shpenzimeve për vitin 2024 gjithsej në vlerën **1.074.041.900** (Njëmiliard e e shtatëdhjetë e katërmilion e dyzetë e një mijë e nëntëqind) lekë, sipas kësaj strukture shpenzimesh:

	<u>Në lekë</u>
- Pagat e punonjësve	320.179.756
- Sigurime Shoqërore dhe shëndetësore	53.470.018
- Shpenzime operative	199.330.742
- Shpenzime kapitale	208.807.315
- Trasferime te Organizata dhe individë	263.552.000
- Fondi për Emergjencat Civile	26.202.069
- Fondi i kontigjencës	2.500.000
TOTALI I SHPENZIMEVE	1.074.041.900

1.4 Te miratoj Planin e të ardhurave për vitin 2024 sipas përputhshmërisë me rregullat fiskale në fuqi për vetëqeverisjen vendore sipas **Tabelës nr.1** pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.

1.5 Te miratoj tavanet e shpenzimeve për çdo program për vitin 2024 sipas **Tabelës nr.2** pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.

1.6 Te miratoj detajimin e shpenzimeve për vitin 2024 në bazë të programeve dhe klasifikimeve buxhetore sipas **Tabelës nr. 3** pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.

1.7 Te miratoj detajimin sipas zerave të investimeve sipas **Tabelës nr.4** pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.

Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Cështjeve Sociale

Aleksander Rama

Drejtor i drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore

Laureta Saliq

KRYETAR

QERIM ISMAILAJ

